



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 475, Datë 21.09.2017**

**Për**

**“Mbylljen e Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare dhe Dhënien e Disa Rekomandimeve”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Juliana	LATIFI	Kryetare
Eduard	YPI	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtare
Leida	MATJA	Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 21.09.2017 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i “Raportit të Hetimit Paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42 dhe neni 43 pika (5) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).  
Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të:

- Raportit të Hetimit Paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi raportin e hetimit paraprak,

**VËREN SE :**

**I- Procedura e ndjekur**

1. Komisioni i Konkurrencës, pas vlerësimit të disa Ankesave lidhur me tregun e telefonisë celulare, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121/2003, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 461, datë 23.05.2017, “Për Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare”, vendosi hapjen e hetimit për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës për periudhën 01.01.2016 deri në 23.05.2017.
2. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 208, datë 23.05.2017 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë

ndërmarrjeve që veprojnë në treg, duke marrë shpjegime për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve.

3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003, është kërkuar informacion nga: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); ndërmarrjet “VODAFONE ALBANIA” SHA (Vodafone), “TELEKOM ALBANIA” SHA (Telekom) “ALBTELECOM” SHA (Albtelecom) dhe “PLUS COMMUNICATION” SHA (Plus).
4. Gjatë procedurës së hetimit paraprak ndërmarrjet Vodafone, Telekom dhe Albtelecom kanë depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës argumentet e tyre lidhur me konstatimet e vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 461, datë 23.05.2017, duke theksuar se kanë vepruar në përputhje me kuadrin ligjor rregullator dhe kanë njoftuar sipas të gjitha procedurave ndryshimet e afateve e tarifave të paketave të tyre.

## **II- Tregu Përkatës**

5. Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, gjatë përcaktimit të tregut përkatës janë marrë në konsideratë dhe kriteret për përcaktimin e tregut sikurse: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.
6. Tregu objekt hetimi është tregu me pakicë i shërbimeve celulare, ku si treg përkatës i produktit janë shërbimet publike të telefonisë së lëvizshme të ofruara nga kompanitë, që përfshijnë aksesin e përdoruesve në rrjet dhe thirrjet dalëse të ofruara nëpërmjet paketave si me parapagim dhe me kontratë. Pra, përdoruesi ka mundësi ta ketë këtë shërbim gjithmonë me vete (nëpërmjet një aparati telefonik celular) dhe disponibël për ta përdorur në çdo vend, të paktën brenda territorit të shërbimit që mbulon operatori, ku përdoruesi është abonuar.
7. Bazuar në sa më sipër, tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha shërbimet publike të telefonisë celulare të ofruar nga kompanitë celulare në tregun e shitjes me pakicë.
  8. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Zona gjeografike e shërbimit të telefonisë së lëvizshme të kompanive celulare me pakicë është territori i Republikës së Shqipërisë. Në bazë të licencave individuale, me të cilat operatorët operojnë, ato ofrojnë shërbimet e tyre, vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

## **III- Pjesët e Tregut**

9. Nga vlerësimi i kriterit të ndarjes së tregut përkatës në tërësi dhe nivelit të

përqendrimit të këtij tregu rezulton se:

- Vodafone Albania, nisur nga pjesët e tregut zotëron konkretisht: sipas të ardhurave totale (48,64 % në vitin 2016); Të ardhurave në retail (nga 54 % në vitin 2015 në 56,18 % në vitin 2016); thirrje dalëse (nga 49,3 % në vitin 2015 në 51,7 % në vitin 2016, duke rënë lehtësisht në 3 mujorin e I-rë 2017); SMS dalëse (66,7 % në vitin 2016, 62,87 % në 3 mujorin e parë 2017); Numrit të pajtimtarëve karta "Sim aktive" (49,4 % në vitin 2016, 48,92 % në 3 mujorin e parë 2017); Numrit të "përdoruesve aktivë" (50,8 % në vitin 2016 dhe 48,22 % në 3 mujorin e parë 2017);
  - Telekom, i cili ka një qëndrueshmëri të pjesëve të tregut për periudhën nën hetim: në përdorues për shërbime për kartat SIM, në thirrje dalëse, në trafik data dhe në të ardhura në pakicë. Telekom zotëron 28,07 % të pjesës së tregut për vitin 2016 për nga kriteri i të ardhurave në tregun me pakicë, duke qëndruar pothuajse në të njëjtën pjesë tregu krahasuar me vitin 2015; ka patur ulje të të ardhurave totale nga 34,3 % në vitin 2015 në 30,68 % në vitin 2016; ka rritur pjesën e tregut për nga numri "përdoruesve aktivë" nga 30,7 % në vitin 2016 në 33,95 % në 3 mujorin e parë 2017;
  - Albtelecom ruan pothuajse në të gjithë treguesit pjesën e tregut për periudhën nën hetim, e cila përfaqësohet për vitin 2016 me 11,6 % sipas të ardhurave totale, 11,15 % sipas të ardhurave në pakicë dhe 14,2 % sipas numrit të pajtimtarëve "Sim aktive" dhe 13,1 % sipas "Përdoruesve aktivë".
  - Plus përfaqësohet me rreth 5% nga të ardhurat në tregun me pakicë, përdorues aktivë dhe karta SIM, përdorues aktivë broadband. Plus ka rënie të pjesëve të tregut për përdorues të shërbimeve celulare telefonike, thirrjeve dhe SMS-ve, të ardhura në pakicë me 1-4.8 %, ndërsa ka fituar 4.3 % pjesë tregu në përdorues akses broadband dhe trafik të dhënash broadband dhe 2,47 % në të ardhurat totale.
  - Treguesi i HHI është shumë i lartë, në nivele përqendrimi 3700-4000, përveç treguesit të SMS-ve që është rreth 5000. HHI është rritur pothuajse në të gjithë treguesit.
10. Nga vlerësimi i kriterit të fuqisë ekonomike-financiare të ndërmarrjeve nën hetim rezultoi se rënia e ndjeshme e fitimeve të Vodafone dhe Telekom (gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015) është shoqëruar edhe me rënien e normave të fitimit të këtyre 2 ndërmarrjeve. Ndërsa ndërmarrja Albtelecom ka rezultate negative në të gjitha vitet edhe gjatë vitit 2016.

#### **IV- Analiza e Sjelljes së Ndërmarrjeve**

11. Gjatë periudhës hetimore janë realizuar inspektive (Daën Raids) në ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës, me qëllim gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një marrëveshje të mundshme ose të një praktike të bashkërenduar mes ndërmarrjeve, por gjatë këtyre inspektiveve nuk u gjetën evidencat direkte apo indirekte që të provojë një marrëveshje apo sjellje të bashkërenduar në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121/2003.

12. Duke qenë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte mes konkurrenteve, gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer analizat ekonomike me qëllim evidentimin e ndonjë sjelljeje të bashkërenduar mes konkurrenteve për fiksimin direkt apo indirekt të tarifave të aplikuara. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës është bazuar në metodologjinë e OECD-së “Hetimi i karteleve pa evidenca direkte” (“Prosecuting cartels without direct evidence”). Bazuar në këtë metodologji, provat rrethore/indirekte ndahen në dy kategori kryesore: 1- Evidenca Komunikimi; dhe 2- Evidenca Ekonomike.
13. Referuar metodologjisë së OECD mbi të cilën është bazuar edhe hetimi i realizuar, konstatohet se padyshim që evidencat ekonomike, ose të quajtura ndryshe edhe të sjelljes, janë prova të cilat mund të përdoren për të provuar një marrëveshje, por në çdo rast evidenca e komunikimit do të ishte më e rëndësishme se ajo ekonomike.

#### **IV.1 Sjellja e Ndërmarrjeve lidhur me kohëzgjatjen e paketave**

14. Ndërmarrja Albtelecom më 15 Mars të vitit 2016 ka ndryshuar numrin e ditëve që paketat mbulonin duke u bërë nga mujore (30 ditore) në 4-javore për paketat Cupid, Paketa 800, Paketa 1000, Paketa 1200 dhe Paketa 1600, ndërkohë që çmimi i paketave dhe njësitë nuk kanë ndryshuar. Gjithashtu për të gjitha paketat, për një periudhë prej 2.5 muaj pas ndryshimit të afatit të përdorimit të paketave, Albtelecom i ofroi abonentëve të vet për çdo aktivizim të paketave, 20 minuta ndërkombëtare dhuratë.
15. Ndërmarrja Telekom më 21 Mars të vitit 2016 ka ndryshuar numrin e ditëve që paketat mbulonin duke u bërë nga mujore (30 ditore) në 4-javore për paketat Vitamina, Medium, Large dhe XLarge, ndërkohë që çmimi i paketave dhe njësitë nuk kanë ndryshuar. Për paketat L dhe XL ky reduktim i numrit të ditëve është shoqëruar me një rritje në numrit të sms-ve ndër/kombëtare të ofruara.
16. Ndërmarrja Vodafone më 23 Mars të vitit 2016 ka ndryshuar numrin e ditëve që paketat mbulonin duke u bërë nga mujore (30 ditore) në 4-javore për paketat Club Extreme/Basic, Club Mix, Club Superior dhe Club Extra, ndërkohë që çmimi dhe njësitë e paketave nuk kanë ndryshuar. Për paketat Club Mix, Club Superior dhe Club Extra ka patur një rritje në numrit të sms-ve ndër/kombëtare të ofruara.
17. Referuar sa më sipër, në Mars të vitit 2016 tre prej kompanive celulare kanë ndryshuar vlefshmërinë e paketave kryesore standarde në harkun kohor të tetë ditëve, përkatësisht Albtelecom me 15 Mars 2016, Telekom me 21 Mars 2016 dhe Vodafone me 23 Mars 2016. Ndryshimi i bërë në këtë periudhë konsiston në ndryshimin e periudhës së mbulimit të paketave nga 30 ditë në 28 ditë, por referuar inspektimeve nuk janë gjetur evidenca direkte apo indirekte që të provojnë që ky ndryshim ka ardhur si pasojë e një marrëveshjeje të ndaluar apo sjelljeje të bashkërenduar midis tyre në kuptim të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003.
18. Sjellja e mësipërme, mund të shpjegohet nga ndërlidhja oligopolistike ku ndërmarrjet përshtatin strategjinë e tyre në kuadër të informacionit të plotë ndaj konkurrentëve të tjerë dhe efekteve të tyre në njësi dhe tarifa.

19. Ky ndryshim i kohëzgjatjes së paketave standarde nga 30 ditë në 28 ditë bën që konsumatori të faturohet rreth 13 muaj në vit në vend të 12 muajve, duke çuar në një rritje vjetore prej rreth 6.5% të buxhetit të shpenzuar nga konsumatori për këtë shërbim.
20. Për ndryshimin e kohëzgjatjes së paketave standarde nga 30 ditë në 28 ditë vlerësojmë se kjo praktikë mund të prekë dhe tregje të tjera në fushën e telekomunikacionit si p.sh. interneti, telefonia fikse, paketat televizive, etj., gjë e cila do të shkaktonte probleme në terma të transparencës dhe krahasueshmërisë së informacionit për pajtimtarët e tyre në lidhje me tarifën e aplikuar për shërbimet e ofruara nga operatorët në sektorin e telekomunikacionit.
21. Referuar sa më sipër, duke qenë se kjo praktikë mund të prekë edhe tregje të tjera në fushën e telekomunikacionit, vlerësojmë që AKEP-i, si organ rregullator i tregut të komunikimeve elektronike në kuadër të kompetencave të tij për mbrojtjen dhe garantimin e mirinformimit të konsumatorit duhet të kryejë vlerësimin e paketave 28 ditore dhe 30 ditore për të parë nëse ka efekte negative për konsumatorin.

#### **IV.2 Sjellja e Ndërmarrjeve lidhur me ndryshimin e njësive**

22. Në Mars 2017, të tre kompanitë celulare kanë ndryshuar paketat standarde kryesore për një periudhë prej rreth 2 javësh, përkatësisht për Vodafone me 24 Mars 2017, Telekom me 27 Mars 2017 dhe Altelecom me 5 Prill 2017. Ndryshimet e kryera janë kryesisht me ulje të çmimeve të paketave për Vodafone përkatësisht nga 1,200 lekë në 1,100 lekë për paketën Club Superior dhe nga 1,600 lekë në 1,400 lekë për paketën Club Extra, të shoqëruara me ulje të njësive të komunikimit të përfshira në paketa. Ndërkohë ndërmarrjet Telekom dhe Altelecom kanë aplikuar rritje të çmimeve të paketave të shoqëruara me rritje të njësive të komunikimit të përfshira në paketa. Një ndryshim i përbashkët nga të tre operatorët është heqja e Internetit pa limit (me shpejtësi të reduktuar) pas konsumit të sasive përkatëse në GB të përfshira në paketë me shpejtësi 3G/4G si dhe reduktimi i minutave ndërkombëtare që ofronin paketat.
23. Referuar analizës së sjelljes së ndërmarrjeve vihet re se në periudhën Mars – Prill 2017, 3 ndërmarrje përkatësisht Vodafone, Telekom dhe Altelecom, për një periudhë 2 javore, duke ndjekur njëra - tjetrën kanë ndryshuar paketat standarde duke shkuar në të njëjtat tarifa dhe numër njësish për disa prej tyre, por referuar inspektimeve nuk janë gjetur evidenca direkte apo indirekte që të provojnë që ky ndryshim ka ardhur si pasojë e një marrëveshjeje të ndaluar apo sjelljeje të bashkërenduar midis tyre në kuptim të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003. Për këtë arsye vlerësojmë që tregu përkatës nën hetim të mbetet nën monitorim për të parë në vazhdimësi sjelljen e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg.
24. Sjellja e mësipërme mund të shpjegohet nga ndërlidhja oligopolistike ku ndërmarrjet përshtatin strategjinë e tyre në lidhje me kombinimin e shërbimeve brenda paketave standarde. Ofrimi i paketave me tarifë të përcaktuar për të gjithë njësitet e paketës dhe jo me çmim të detajuar për çdo element të saj (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.) krijon konfuzion për konsumatorët.

25. Sipas OECD<sup>1</sup>, kur konsumatorët nuk kanë informacion të mjaftueshëm, ose cilësia e tij është keq informuese ata mund të krijojnë konfuzion nga ofertat dhe të paguajnë më tepër ose mund të blejnë shërbime të cilat nuk i nevojiten. Fuqia e konsumatorëve dhe mbrojtja e tyre është shumë e rëndësishme nga aspekti ekonomik dhe social.
26. Në bazë të nenit 9, pika 2 të Ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9902.2008), është përcaktuar: *“Për të gjitha shërbimet që i ofrohen konsumatorëve është i detyrueshëm shënimi i çmimit të shërbimit të ofruar. Nëse shërbimi përbëhet nga disa pjesë të ndryshme e të veçanta, jepen çmimi i secilës prej tyre dhe çmimi përfundimtar. Nëse në çastin e lidhjes së kontratës nuk është dhënë ende çmimi përfundimtar, ofruesi i shërbimit është i detyruar të tregojë metodën e përlllogaritjes së tij.”*
27. Referuar paketave standarde të ofruara nga operatorët e telefonisë celulare rezulton se nga ana e tyre nuk jepet asnjë informacion për konsumatorin lidhur me çmimin për njësi për elementët që paketat përmbajnë, e cila do t’u jepte mundësi atyre të zgjidhnin në mënyrë objektive paketën që ju përshtatet nevojave të tyre. Kjo praktikë tregtare dobëson ndjeshëm aftësinë e konsumatorit për marrjen e një vendimi lidhur me zgjedhjen e paketës që i përshtatet më mirë nevojave të tij.
28. Për sa më sipër, lidhur me informacion e plotë dhe transparent për konsumatorët nevojitet ndërhyrja e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si organ vendimmarrës në kuptim të Ligjit Nr. 9902/2008, për të detyruar operatorët e telefonisë celulare bërjen transparent të çmimit për njësi për çdo shërbim të përfshirë në paketat e hedhura në treg.

### **IV.3 Rregullimi i Tregut**

29. Lidhur me ndryshimin e kohëzgjatjes së paketave standarde nga 30 ditë në 28 ditë, AKEP-i në raportin e tij vjetor për vitin 2016 shprehet se: *“Ndryshimet e ndodhura në Mars të vitit 2016 përfshijnë ndryshimin nga Albtelecom, Telekom Albania dhe Vodafone të afatit të përdorimit të ofertave mujore nga 30 ditë në 28 ditë. Operatorët kanë zbatuar detyrimet e transparencës dhe publikimit të tarifave për këtë ndryshim. Ndryshimi i afatit rezulton të jetë bërë për shkaqe kompatibiliteti të afateve (ditore, javore dhe 4 javore) si dhe është në vijim të praktikave të përdorura edhe nga operatorë celularë në vende të tjera evropiane.”*
30. Në lidhje me ndryshimet e kryera nga tre operatorë celularë në periudhën 24 Mars - 5 Prill 2017, AKEP-i sqaron, si më poshtë:
  - 1) *“Nga komunikimet me operatorët sipas AKEP rezulton se kjo shprehje “Internet pa limit” është hequr pasi krijon konfuzion te shumë përdorues, të cilët prisnin të konsumonin me shpejtësi të lartë Internet pa limit. Operatorët nuk kanë ndryshuar sasinë e përfshirë me shpejtësi të lartë 3G/4G, por kanë hequr vetëm*

<sup>1</sup> <https://www.oecd.org/sti/consumer/40679279.pdf>

*pjesën me shpejtësi të reduktuar. Pra nuk ka ndryshim në sasinë e GByte me akses broadband celular, por vetëm heqje të aksesit narrowband celular (me shpejtësi të ulët).*

*Në lidhje me kuadrin ligjor, AKEP sqaron se është organ rregullator që mbikëqyr zbatimin e Ligjit Nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ndërsa zbatimi i Ligjit Nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” është kompetencë e MZHETTS dhe Komisionit përkatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve.*

*Në lidhje me zbatimin e detyrimeve për transparencë të tarifave AKEP sqaron si më poshtë:*

- 2) *Në lidhje me cilësinë e shërbimeve celulare, ... ndryshimet e kryera variojnë sipas operatorëve, dhe rastet e rritjes së tarifave janë shoqëruar me rritje të sasisë së komunikimeve të përfshira në çmimet e paketave. Vlen të theksojmë se përsa i përket nivelit të konkurrencës në treg dhe përfitimeve të konsumatorit shqiptar nga shërbimet celulare, analizat e AKEP si dhe raporte të institucioneve ndërkombëtare (ITU-“Measuring the Information Society Report” 2016), tregojnë për rritje të ndjeshme të përfitimeve të konsumatorëve nga këto shërbime, sidomos aksesit broadband në rrjete celulare 3G/4G në vitet e fundit, si dhe për tarifa të përballueshme.*
31. Nga analiza e tregut të shërbimeve të telefonisë celulare ndërmarrjet janë të detyruara të njoftojnë në AKEP ndryshimet e paketave të tyre dhe në përputhje me parashikimet e nenit 54 të Ligjit Nr. 9918/2008, sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun ka detyrimin: a) të publikojë tarifat e shërbimeve dhe të mundësojë informimin e publikut edhe nëpërmjet aksesit në distancë; b) të njoftojë, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifat e shërbimeve, jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre dhe ky njoftim duhet të bëhet për jo më pak se 3 ditë rresht; c) të paraqesë në AKEP tarifat e shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre.
32. Në bazë të nenit 8 të Rregullores Nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, sipërmarrësit janë të detyruar të paraqesin në AKEP informacionin mbi mënyrën e publikimit të tarifave dhe shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre. Ky informacion duhet të dërgohet në AKEP në rrugë elektronike dhe/ose shkresore, jo më vonë se 3 ditë pas bërjes efektive të tarifave/ndryshimeve.
33. Pra, referuar sa më sipër, të gjitha ndryshimet e ndodhura në paketat standarde nga ana e ndërmarrjeve nën hetim, janë njoftuar në AKEP 3 (tre) ditë pas hyrjes së tyre në fuqi. Parë nga këndvështrimi i konkurrencës, duke qenë se AKEP-i si rregullator i tregut vepron ex ante për parandalimin dhe identifikimin e sjelljeve antikonkurruese, vlerësojmë se njoftimi për ndryshimin e paketave standarde duhet të kryhet para bërjes efektive të tyre në treg, gjë e cila do ti jepte mundësinë AKEP-it që të kryente një vlerësim paraprak të tyre.
34. Në bazë të nenit 98, pika 2 të Ligjit Nr. 9918/2008 AKEP-i duhet të miratojë rregulla për të mundësuar dhe garantuar që konsumatorët mund të marrin vendime të mirinformuar.

35. Siç është përmendur edhe më lart, referuar paketave standarde të ofruara nga operatorët e telefonisë celulare rezulton se nga ana e tyre nuk jepet asnjë informacion për konsumatorin lidhur me çmimin për njësi për elementët që paketat përmbajnë, e cila do t'u jepte mundësi atyre të zgjidhnin në mënyrë objektive paketën që ju përshtatet më mirë nevojave të tyre.
36. Për sa më sipër, lidhur me informacion e plotë dhe transparent për konsumatorët nevojitet që AKEP-i në Rregulloren Nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, duhet të përcaktojë detyrimin e operatorëve të shërbimit celular që përveç çmimit të paketës standarde nga ana e ndërmarrjeve të publikohet dhe çmimi për çdo njësi që këto paketa përmbajnë.
37. Në bazë të nenit 61 të Ligjit Nr. 9918/2008, “Kontrolli i veçantë ndaj sjelljeve antikonkurrese”, sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike, nuk duhet të abuzojnë me pozitën e tyre në treg. Kur AKEP-i, me nismën e vet, ose nëpërmjet njoftimit nga sipërmarrës të tjerë apo palë të tjera të interesuara, gjykon se sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg po abuzon me pozitën e tij, e parashtron rastin përpara Autoritetit të Konkurrencës, duke i kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore.
38. Në analizën e tregut 2016, vetë AKEP-i ka evidentuar si problematikë diferencën e lartë të tarifave për shërbimet e konsumuara për njësi (lekë/minutë, SMS) me tarifën e shërbimeve të përfshira në pagesën fikse si pjesë e ofertave. Këto tarifa aplikohen nëse përdoruesi me parapagim nuk blen paketa/oferta ose pasi ka konsumuar njësitë përkatëse të përfshira në çmimin e paketës/ofertës, si dhe për përdoruesit me kontratë pas konsumit të njësisve të përfshira në pagesën fikse mujore dhe/ose të paketave/opsioneve shtesë që mund të blejë kjo kategori përdoruesish.
39. Këto tarifa rezultojnë të jenë shumë herë më të larta se tarifën mesatare që aktualisht paguajnë përdoruesit celularë. Çmimi që një përdorues celular ka paguar mesatarisht për një minutë thirrje telefonike nga rrjete celulare në vitin 2015 ishte 2.83 lekë/minutë me TVSH, ndërsa tarifën standarde të thirrjeve jashtë paketave janë deri 14 herë më të larta se kjo vlerë mesatare. Në mënyrë të ngjashme edhe tarifimi për aksesin broadband jashtë paketave tregon për nivel shumë të lartë të tyre dhe diferenca të mëdha me aksesin broadband në paketa (parapagim/paspagim).
40. Përderisa përdoruesit e tarifave standarde zënë një pjesë shumë të vogël, pasi vetëm 0.7% të thirrjeve në vitin 2016 janë tarifuar me tarifën standarde, vlerësojmë se kjo përqindje e ulët është si rezultat i tarifave të larta që aplikohet për këtë segment tregu.
41. Referuar sa më sipër, tarifën standarde të aplikuar nga operatorët e telefonisë celulare janë disa herë më të larta se tarifa e terminimit të thirrjeve (1.48 lekë/min). Lidhur me këtë segment të vogël tregu, AKEP-i, si rregullator i këtij tregu, me



qëllim zhvillimin e tij në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve duhet të ndërhyjë për të nxitur rritjen e tij dhe orientimin drejt kostos, duke kryer dhe analizën lidhur me operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.

42. Njoftimi paraprak në AKEP i ndryshimit të paketave standarde nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e shërbimit të telefonisë celulare me pakicë do t'i jepte mundësinë rregullatorit që të vlerësonte ex ante këto paketa për të parandaluar ndonjë sjellje të mundshme antikonkurruese nga këto ndërmarrje dhe për t'ia parashtruar çështjen Autoritetit të Konkurrencës, duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse. Për të realizuar vlerësimin ex ante të ndryshimit apo hedhjes së paketave të reja në treg duhet që AKEP të ndryshojë nenin 8 të Rregullores Nr. 27/2012 "Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike", duke vendosur detyrimin për njoftim ndaj ndërmarrjeve përpara bërjes efektive të tarifave/ndryshimeve.
43. AKEP-i, si organ rregullator i tregut të komunikimeve elektronike në kuadër të kompetencave të tij për mbrojtjen dhe garantimin e mirinformimit të konsumatorit duhet të përcaktojë për operatorët e shërbimit celular detyrimin që përveç çmimit të paketës standarde nga ana e ndërmarrjeve të publikohet dhe çmimi për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB etj.) që këto paketa përmbajnë.
44. Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit, në kuadër të mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve, vlerësojmë si të nevojshme ndërhyrjen e tij duke kërkuar nga ana e operatorëve të telefonisë celulare përmbushjen e detyrimit që për çdo ndryshim apo hedhje të paketave të reja në treg që ka efekt të drejtpërdrejtë tek konsumatori të kërkojë transparencë çmimi për njësi për çdo shërbim të ofruar (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.)

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42, nenin 43, pika (5) dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:
  - 1.1 *Të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për çdo paketë standarde/oferta të njoftuar nga ndërmarrjet që operojnë në tregun e telefonisë celulare që sjell efekte antikonkurruese në treg në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 12, nenin 38 dhe nenit 61 të Ligjit Nr. 9918/2008;*
  - 1.2 *Të kërkojë opinionin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo ndryshim të strukturës së tregut që mund të sjellë pasoja për konkurrencën;*
  - 1.3 *Brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në bazë të nenit 70 të Ligjit Nr. 9121/2003, të marrë masat si vijon:*

- a. *Të bëjë vlerësimin e paketave 28 ditore dhe 30 ditore për të vlerësuar nëse ka efekte negative për konsumatorin duke u shprehur me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it;*
  - b. *Ndryshimin e nenit 8 të Rregullores Nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, duke parashikuar detyrimin e ndërmarrjeve për njoftimin në AKEP përpara bërjes efektive të miratimit të tarifave/ndryshimeve;*
  - c. *Të përcaktojë për operatorët e shërbimit celular detyrimin që përveç çmimit të paketës standarde nga ana e ndërmarrjeve të publikohet dhe çmimi për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.), që këto paketa përmbajnë;*
  - d. *Të parashtojë përpara Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjellje antikonkurrese nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e komunikimeve elektronike;*
  - e. *Të kryej analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifatat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.*
2. *Ti rekomandojë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si vijon:*
    - 2.1 *Të kërkojë nga ana e operatorëve të telefonisë celulare përmbushjen e detyrimit që për çdo ndryshim apo hedhje të paketave të reja në treg që ka efekt të drejtpërdrejtë tek konsumatori të kërkojë transparencë çmimi për njësi për çdo shërbim të ofruar (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.);*
  3. *Ndërmarrjet që operojnë në tregun e telefonisë celulare brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të marrin masa për aplikimin dhe publikimin e çmimit për njësi për çdo shërbim (lekë/min., lekë/sms, lekë/MB, etj.) që përmbajnë paketat standarde, duke informuar Autoritetin e Konkurrencës;*
  4. *Monitorimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës të tregut me pakicë të shërbimeve celulare për një periudhë 1 (një) vjeçare, e cila fillon nga data 1 Tetor 2017.*
  5. *Gjatë periudhës së monitorimit ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në këtë treg duhet të njoftojnë paraprakisht pranë Autoritetit të Konkurrencës të gjitha ndryshimet e kryera në paketa standarde, oferta promovionale, tarifa standarde, etj., që do të hedhin në treg;*
  6. *Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare;*

7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi dhe monitorimin e tregut me pakicë të shërbimeve celulare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**